

REPUBLICA E SHQIPËRIE
BASHKIA E VLORË



6455
25.04.2025

REPUBLICA E SHQIPËRIE
BASHKIA E VLORË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 497 prot.

Vlorë, më 22, 04.2025

Lënda: Informacion mbi problematikat e konstatuara në sistemin e ujitjes dhe kullimit.

**Drejtuar : SEKRETARIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË
Z.DAUT ZËRAJ**

Për dijeni : Bashkia Vlorë - Kabineti

Për informacionin e kërkuar nga Këshilli Bashkiak Vlorë me shkresën nr 5704 Prot., datë 11.04.2025 për problematikat e konstatuara në sistemin e ujitjes dhe kanalizimeve dhe masat e marra për përmirësimin e gjendjes, po ju paraqesim më poshtë një përmbledhje kryesore të problematikave kryesore me të cilat përballlet ky sektor, si dhe disa propozime konkrete për ndërhyrje dhe përmirësim të situatës:

- 1- Gjendja e infrastrukturës. Rrjeti ekzistues i kanaleve ujitës është në gjendje të amortizuar dhe në gjendje jo të mirë teknike, duke e bërë rrjetin pjesërisht funksional. Një pjesë e konsiderueshme e kanaleve sekondare dhe terciare janë të bllokuara osë të pushtuara nga bimësia e egër si dhe e butë e mbjellë rishtaz nga persona të paautorizuar, mbetje të ngurta apo edhe ndërtime. Stacionet e pompimit janë jashtë funksionit.
- 2- Burime njerëzore të kufizuara. Sektori operon me mungesë të theksuar të stafit teknik dhe mjeteve logjistike. Nevojitet gjithashtu përmirësim i kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve.
- 3- Ndotja dhe abuzimi me rrjetin kullues. Depozitimi i mbetjeve urbane dhe inerteve në kanale nga individë dhe subjekte private është kthyer në një shqetësim serioz, pasi

ndotja e ujërave përbën rrezik jo vetëm për tokat bujqësore por edhe për biodiversitetin në zonat përreth.

- 4- Mungesë e ndërveprimit me komunitetin bujqësor. Ka mungesë strukturash bashkëpunuese me fermerët për menaxhimin dhe monitorimin e sistemeve ujitëse, modeli i OPU apo organizata të tjera bujqësore, të cilat duhet të nxiten për krijim. Pagesa e tarifave nga ana e përfituesve është në nivele të ulëta për shkak të mungesës së stafit menaxhues të shërbimit, strukturës menaxhuese apo perceptimit për cilësinë e shërbimit.

Propozimet tona konkrete për Këshillin e Bashkisë Vlorë janë :

- 1- Hartimi dhe miratimi i një plani strategjik 3-vjeçar për rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit.
- 2- Krijimi i ekipeve të përbashkëta pune midis Bashkisë, fermerëve dhe Njësive Administrative për kontroll dhe ndërhyrje emergjente, në rast të moskrijimit të OPU apo organizatave bujqësore për administrimin e ujitjes.
- 3- Buxhet specifik për ndërhyrjet e mundshme emergjente.
- 4- Plotësimi me staf teknik i sektorit të Bordit të Ujitjes dhe Kullimit si pasojë e mungesës së theksuar në burime njerëzore.

Të merret parasysh shtimi në strukturë:

Mekanik për mjetet e rënda

Specialist të sektorit të bujqësisë (agronom)

Mirëmbajtjes/kujdestar rezervuarësh,

Përgjegjës/brigadier për hidrovorin

apo cdo personel tjetër i sugjeruar nga ana juaj për mbarëvajtjen e sektorit.

Rikuperimi dhe menaxhimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit përbën një domosdoshmëri për zhvillimin rural dhe mbështetjen e bujqësisë në territorin e Bashkisë Vlorë. Kërkojmë mbështetjen tuaj për ti dhënë prioritet kësaj çështjeje.

P.sektori i ujitjes dhe kullimit

Alpin Skëndaj

DREJTORI
Dorian Xhelili

